

**PYETËSORI NDËRKOMBËTAR I TRAUMËS – PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA INTELEKTUALE- VERSIONI SHQIP
THE INTERNATIONAL TRAUMA QUESTIONNAIRE – INTELLECTUAL DISABILITIES
(ITQ)- ALBANIAN VERSION
Përkthyer në gjuhën shqipe nga Alfred Nela**

PËRMBLEDHJE:

Një version fillestar dhe paraprak me 23 pyetje i Pyetësorit Ndërkombëtar të Traumës (ITQ: Cloitre, Roberts, Bisson, & Brewin, 2015) operacionalizoi përshkrimet narrative të Çrregullimit të Stresit Posttraumatik (ÇSPT) dhe Çrregullimit Kompleks të Stresit Post-Traumatik (ÇKSPT), siç përcaktohet në versionin e 11-të klasifikimit statistikor ndërkombëtar të sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin (ICD-11). **Ky është një version i përshtatur për njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe aftësi të tjera të kufizuara në zhvillim. Është zhvilluar me një grup këshillues të personave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe autizëm. Ky version duhet të administrohet si një intervistë gjysmë e strukturuar.**

Duke përdorur mostra të personave pa aftësi të kufizuara intelektuale, analiza e teorisë së përgjigjeve të pyetjeve, (Item response theory-IRT), u aplikua në të dhënat nga një mostër komunitare e ekspozuar ndaj traumave dhe një mostër klinike e ekspozuar ndaj traumave nga Mbretëria e Bashkuar, dhe rezultatet ofruan një bazë empirike për përzgjedhjen e një liste prej 12 treguesish të simptomave të Çrregullimit të Stresit Post-Traumatik (ÇSPT) dhe Çrregullimit Kompleks të Stresit Post-Traumatik (ÇKSPT). Rezultatet e analizës së faktorëve konfirmues zbuluan se struktura latente e ITQ ishte në përputhje me gjetjet e mëparshme, dhe shkallët diagnostikuese të ÇSPT dhe CPTSD ishin në përputhje me vlerësimet e mëparshme bazuar në versionin e fazës paraprake [1-3]. Instrumenti që rezultoi është një masë e shkurtër, e formuluar thjesht, që përqendrohet vetëm në tiparet kryesore të ÇSPT dhe ÇKSPT, dhe përdor rregulla të thjeshta diagnostikuese. Prandaj, ITQ është në përputhje me parimet e klasifikimit statistikor ndërkombëtar të sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin, revizioni i 11-të (ICD-11), siç përcaktohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, për të maksimizuar dobinë klinike dhe për të siguruar zbatueshmërinë ndërkombëtare përmes një fokusi në simptomat kryesore të një çrregullimi të caktuar. ITQ është i disponueshëm lirisht për të gjitha palët e interesuara.

Duhet ta përdorni Formularin e Informacionit për Traumën fillimisht me të anketuarin tuaj (Hall, Jobson dhe Langdon, 2014). Kjo bëhet për t'u siguruar që ata e kuptojnë se çfarë nënkuptojmë me fjalën "traumë" dhe ngjarjen traumatike për të cilën po i pyetni. Formulari i Informacionit për Traumën mund të shkarkohet këtu: <http://wrap.warwick.ac.uk/132892/> ose këtu: https://www.researchgate.net/publication/282359150_Trauma_Information_Form_TIF

ALGORITMET DIAGNOSTIKE janë si më poshtë:

ÇSPT.

Një diagnozë e ÇSPT kërkon miratimin e njërit prej dy simptomave nga secili prej tre grupeve të simptomave të ÇSPT, plus miratimin e dëmtimit funksional të shoqëruar me këto simptoma.

ÇKSPT.

Një diagnozë e ÇKSPT kërkon që kriteret e ÇSPT -së të përmbushen, dhe miratimin e njërit prej dy simptomave nga secili prej tre grupeve të simptomave të çrregullime në vetëorganizim (DSO), plus miratimin e dëmtimit funksional të shoqëruar me këto simptoma.

REFERENCAT

1. Brewin, C. R., Cloitre, M., Hyland, P., Shevlin, M., Maercker, A., Bryant, R. A.,...Reed, G. M. (2017). A review of current evidence regarding the ICD-11 proposals for diagnosing PTSD and complex PTSD. *Clinical Psychology Review*, 58, 1-15. doi: 10.1016/j.cpr.2017.09.001.

2. Karatzias T., Shevlin M., Fyvie C., Hyland P., Efthymiadou E., Wilson D.,...Cloitre M. (2017). Evidence of distinct profiles of posttraumatic stress disorder (PTSD) and complex posttraumatic stress disorder (CPTSD) based on the new ICD-11 trauma questionnaire (ICD-TQ). *Journal of Affective Disorders*, 207, 181-187.
<http://dx.doi.org/10.1016/j.jad.2016.09.032>
3. Hall, J.C., Jobson, L. and Langdon, P.E. (2014). Measuring symptoms of post-traumatic stress disorder in people with intellectual disabilities: The development and psychometric properties of the Impact of Events Scale – Intellectual Disabilities (IES-IDs). *British Journal of Clinical Psychology*, 53, 315-332.
<https://doi.org/10.1111/bjc.12048>
4. Hyland, P., Shevlin M., Brewin C.R., Cloitre M., Downes A.J., Jumbe, S.,...Roberts, N.P. (2017). Validation of post- traumatic stress disorder (PTSD) and complex PTSD using the International Trauma Questionnaire. *Acta Psychiatrica Scandinavica*. 136, 313-322. doi: 10.1111/acps.12771.

PYETËSORI NDËRKOMBËTAR I TRAUMËS – PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE- VERSIONI SHQIP

Udhëzime: Ju lutemi identifikoni përvojën që e shqetëson më shumë personin duke përdorur Formularin e Informacionit për Traumën, të administruar si një intervistë gjysmë e strukturuar. Referojuni fletës së udhëzimeve me figura sipas nevojës.

Regjistroni traumën këtu: _____

Kur ndodhi ngjarje? (rrethoni një)

- a. më pak se 6 muaj më parë
- b. 6 deri në 12 muaj më parë
- c. 1 deri në 5 vjet më parë
- d. 5 deri në 10 vjet më parë
- e. 10 deri në 20 vjet më parë
- f. më shumë se 20 vjet më parë

"Do të lexoj disa probleme me të cilat përballen njerëzit që kanë përjetuar trauma; a mund të më tregoni nëse keni pasur ndonjë nga këto probleme muajin e fundit duke thënë po, ndonjëherë ose jo kur ju bëj pyetjen?"	Jo	Ndonjëherë	Po
1. A po shihni ankthe për gjërat e këqija që ju kanë ndodhur?	0	1	2
2. A po keni kujtime për gjërat e këqija që ju vijnë në mendje dhe ju trembin?	0	1	2
3. A jeni përpjekur të mos mendoni për gjërat e këqija?	0	1	2
4. A jeni përpjekur të mos shkoni në vende që ju kujtojnë gjërat e këqija që kanë ndodhur?	0	1	2
5. A jeni ndjerë shumë të frikësuar shumë herë?	0	1	2
6. A jeni ndjerë shumë të shqetësuar?	0	1	2

"Muajin e kaluar, gjërat për të cilat sapo folëm: "

7. Domethënë që u grindeshe me miqtë e tu?	0	1	2
8. Domethënë që nuk mund të shkoje në punë ose të bëje aktivitetet e tua?	0	1	2
9. Domethënë që nuk mund të bëje gjërat që bën normalisht, si shkolla, hobi apo gjëra të tjera?	0	1	2


“Do të lexoj disa probleme të tjera me të cilat përballen njerëzit që kanë pasur trauma; a mund të më tregoni nëse ndiheni në përgjithësi kështu duke thënë po, ndonjëherë apo jo kur ju bëj pyetjen?”	Jo	Ndonjëherë	Po
“Sa e vërtetë është kjo për ju?”			
1. Kur jam i mërzitur, më duhet shumë kohë të qetësohem.	0	1	2
2. Ndihehem i trishtuar	0	1	2
3. Ndihehem si një dështak	0	1	2
4. Ndihehem i pavlerë	0	1	2
5. Ndihehem sikur nuk kam miq	0	1	2
6. E kam të vështirë të jem pranë njerëzve	0	1	2

“Gjatë muajit të kaluar, ke pasur ndjenjat dhe mendimet e këqija për të cilat sapo folëm:”	Jo	Ndonjëherë	Po
1. Domethënë që u grindeshe me miqtë e tu?	0	1	2
2. Domethënë që nuk mund të bëje punën ose aktivitetet e tua?	0	1	2
3. Domethënë që nuk mund të bëje gjërat që bën normalisht, si shkolla, hobi apo gjëra të tjera?	0	1	2

1. Mankthe



2. Kujtime



3. Të mendosh për gjëra të këqija



4. Vende





5. Ndihem i frikësuar




6. Ndihem i tensionuar



7. Grindem me shokët




8. Puna dhe aktivitetet e zakonshme



9. Gjërat që të pëlqen të bësh




1. Koha për t'u qetësuar



2. Ndihem i trishtuar



3. Ndihem dështak



4. Ndiheh i/e pavlerë



5. Ndhihem sikur nuk kam shokë



6. E kam të vështirë të qëndroj me njerëzit e tjerë

